


Aksidentet Rrugore

Shkurt 2018

Tiranë, më 21 Mars 2018 Në muajin Shkurt 2018 numërohen 113 aksidente rrugore, nga 117 aksidente të ndodhur në Shkurt 2017, duke u ulur me 3,4 %.

Fig. 1 Aksidentet rrugore mujore, Shkurt 2014 - Shkurt 2018



Në Shkurt 2018, numri i të aksidentuarve është 148 persona nga 159 që ishte një vit më parë, duke u ulur 6,9 %. Numri i të aksidentuarve në dymujorin e parë 2018, është rritur 1,9 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Në muajin Shkurt 2018, numri i të vdekurve nga aksidentet rrugore është 20 persona, nga 17 që ishte një vit më parë për të njëjtën periudhë, duke u rritur 17,6 %. Në dymujorin e parë 2018, numri i të vdekurve nga aksidentet rrugore është ulur 15,4 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Në Shkurt 2018, aksidentet rrugore, në 85,0 % të rasteve, kanë ndodhur si pasojë e sjelljes së drejtuesit të mjetit. Numri më i lartë i aksidenteve në këtë periudhë është kryer nga grup mosha 25 – 35 vjeç, duke zënë 32,7 %, duke u ulur me 5,1 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Në dymujorin e parë 2018, aksidentet rrugore, në 20,6 % të rasteve, kanë ndodhur si pasojë e sjelljes së këmbësorit. Gjatë kësaj periudhe numri i të aksidentuarve sipas sjelljes së këmbësorit është rritur 30,8 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Tab. 1 Aksidentet rrugore

Periudha	Aksidente	Të vdekur		Të plagosur	
	Gjithsej	Femra	Meshkuj	Femra	Meshkuj
Shkurt 2017	117	3	14	37	105
Shkurt 2018	113	6	14	29	99
Ndryshimi vjetor (%)	-3,4	100,0	0,0	-21,6	-5,7
Janar-Shkurt 2017	236	8	31	88	190
Janar -Shkurt 2018	247	7	26	80	210
Ndryshimi vjetor progresiv (në %)	4,7	-12,5	-16,1	-9,1	10,5

Tab. 2 Aksidentet rrugore, sipas përdoruesve të rrugës, Shkurt

Periudha	Aksidente sipas		Të vdekur sipas	
	Sjellja e Drejtuesit të Mjetit	Sjellja e Këmbësorëve	Sjellja e Drejtuesit të Mjetit	Sjellja e Këmbësorëve
Shkurt 2017	98	19	13	4
Shkurt 2018	96	17	17	3
Ndryshimi vjetor (%)	-2,0	-10,5	30,8	-25,0
Janar-Shkurt 2017	197	39	31	8
Janar-Shkurt 2018	196	51	26	7
Ndryshimi vjetor progresiv (%)	0,5	30,8	-16,1	-12,5

Tab. 3 Aksidentet rrugore, sipas moshës së drejtuesit të mjetit

Periudha	Aksidente sipas moshës së drejtuesit të mjetit						Larguar nga vendi i ngjarjes
	0 - 16 vjeç	16 - 25 vjeç	25- 35 vjeç	35- 45 vjeç	45-60 vjeç	60+ vjeç	
Shkurt 2017	0	24	39	15	24	5	10
Shkurt 2018	1	28	37	13	17	7	10
Ndryshimi vjetor (%)		16,7	-5,1	-13,3	-29,2	40,0	0,0
Janar-Shkurt 2017	1	55	67	36	46	11	20
Janar-Shkurt 2018	1	54	60	41	50	17	24
Ndryshimi vjetor progresiv (%)	0,0	-1,8	-10,4	13,9	8,7	54,5	20,0

Tab. 4 Aksidentet rrugore sipas qarqeve,

Periudha	Aksidente		Të vdekur		Aksidente		Të vdekur	
	Shkurt 2017	Shkurt 2018	Shkurt 2017	Shkurt 2018	Jan.-Shkurt 2017	Jan.-Shkurt 2018	Jan.-Shkurt 2017	Jan.-Shkurt 2018
Shqipëria	117	113	17	20	236	247	39	33
Tiranë	44	53	2	5	100	114	9	8
Durrës	12	17	0	2	26	34	2	4
Shkodër	5	4	4	7	8	6	7	8
Elbasan	10	9	1	3	23	18	4	6
Fier	7	3	1	1	14	8	4	2
Vlorë	11	4	3	0	14	12	4	0
Korce	6	3	0	0	8	6	0	0
Lezhë	13	12	2	0	25	25	3	2
Berat	2	2	0	0	4	8	0	1
Kukës	1	1	0	1	2	3	0	1
Diber	3	2	0	1	6	6	0	1
Gjirokastër	3	3	4	0	6	7	6	0

Përkufizime

Aksidente: Aksidentet rrugore që ndodhin tek një ose më shumë persona që goditen nga mjetet e qarkullimit rrugor.

I vdekur: I vdekur nga aksidenti në rrugë quhet çdo person i cili ka vdekur menjëherë ose brenda 30 ditëve si rezultat i aksidentit.

I plagosur: I plagosur konsiderohet çdo person, i cili nuk ka vdekur por ka marrë plagë të lehta apo të rënda si rezultat i aksidentit.

Sjellja e Drejtuesit të Mjetit : Nënkupton nëse drejtuesi i mjetit nuk zbaton rregullat e qarkullimit rrugor sipas “Kodit Rrugor” si: frenim i papritur, injoron shenjat (sinjalistikën) e trafikut, mosrespektimi i normave të shpejtësisë etj.

Sjellja e Këmbësorëve: Nënkupton nëse këmbësori nuk zbaton rregullat e qarkullimit rrugor sipas “Kodit Rrugor” si : kalim rruge pa kujdes, etj.

Burimi i të dhënave: Të dhënat janë siguruar nga Ministria e Punëve të Brendshme/Drejtoria e Policisë së Shtetit.

Të dhënat e muajit të fundit mbi Personat e vdekur nga aksidentet rrugore janë paraprake dhe subjekt rishikimi. Për më shumë referohu: <http://www.instat.gov.al/rreth-nesh/cilesia-statistikore.aspx> Politika e revizionimit statistikor.